



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**Nr. 08**

**Datë: 15. 02. 2024.**

**Ora: 13:30**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shëf i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 02, 03, 04/2024**
- 3. Aktivitetet e Zyrës:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për shqiptimin e gjobave për vonesat në dorëzimin e formularëve të azhurnimit vjetor 2024

- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit të KQZ-së**
- 5. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

#### **2.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës dhe projektit për punëtori me ZEKKZ

## 2.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtorë me zyrtarët ekzekutiv të zgjedhjeve për planin e punës dhe planifikim;

## 2.3. Këshilli për Çështje Ligjore

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Skenderaj dhe në Dragash

## 6. Të ndryshme

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim të mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e mbledhjes. Pastaj, ai pyeti lidhur me rendin e ditës. Nuk pati vërejtje, propozime etj. Në vazhdim, u miratuan me vota unanime procesverbalet nr. **02, 03, 04/2024** nga mbledhjet e KQZ-së.

### 2. Aktivitetet e Zyrës:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për shqiptimin e gjobave për vonesat në dorëzimin e formularëve të azhurnimit vjetor 2024:

**Besnik Buzhala**, drejtor i Zyrës, tha se në bazë të rregullores nr.1/2021, partitë politike obligohen që për çdo vit kalendarik, më së largëti deri më 31 janar të dorëzojnë raportin e azhurnimeve vjetore. Nga 50 parti që janë të regjistruara, 46 parti kanë dorëzuar raportet. Dy parti, kanë dorëzuar raportet e azhurnimit, mbas datës 31 janar. Dy parti, nuk kanë dorëzuar fare formularë të azhurnimit vjetorë. Zyra, rekomandon për partinë politike “Kosovskih serba” e cila, e ka dorëzuar raportin me 5 shkurt 2024, ti shqiptohet dënimi gjorbë në shumën 250 euro, ashtu siç parashihet me rregullore. Ndërsa, për partinë politike “Kosova adalet partis”, e cila ka dorëzuar raportin e azhurnimit më datën 8 shkurt 2024, ti shqiptohet gjoba në vlerë prej 500 euro. Dy parti që nuk kanë dorëzuar fare raport, janë “Shpresa demokrate” dhe partia “Forca e diasporës”. Partia e parë, meqë është themeluar vitin e kaluar dhe ende se ka mbajtur kuvendin vjetorë ashtu si e obligon ligji, nuk ka pasur se çfarë të raportoj. Kurse, për partinë tjetër zyra rekomandon që mos ti shqiptohet gjorbë, sepse kjo parti më datën 18 janar 2024, ka bërë kërkesë

për c'regjistrim. Janë procedurat, se si bëhet çregjistrimi, prandaj zyra rekomandon mos ti shqiptohet dënimi – gjoba...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e zyrës për shqiptimin e gjobës ndaj partisë “Kosovskih serba”, në masë prej 250 euro, dhe ndaj partisë “Kosova adalet partisi”, në masë prej 500 euro.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit të KQZ-së:**

**Burim Ahmetaj**, drejtor i SKQZ-së, tha se KQZ ka formuar komision të Planit të Integritetit të KQZ-së. Nëse na lejoni, raportin do ta bëjë Emira ALushi, e cila është kryesuese e këtij komisioni.

**Emira Alushi**, tha se KQZ ka formuar komisionin nga unë Emira ALushi, Vesa Xharra dhe Krehnik Spahiu. Sipas udhëzimeve që kemi marrë nga agjencia antikorrupsion, e kemi hartua planin tonë të integritetit 2024 – 2026. Në vazhdim, znj. Alushi paraqiti qëllimet, objektivat e planit, si dhe zbatimin e tij.

**Alban Krasniqi**, tha se ky plan, ashtu si e kam shqyrtuar, duke ba edhe krahasimin kam vërejtur se plani i ka disa mangësi: do ti numëroj disa. E para, si pyetje: aspektet që ndërlidhen me planin që ndërlidhen me Zyrën, a janë përfshi të gjitha, rrezikshmëria, ku janë përfshi dhe a janë përfshi në masën e duhur. Tjetra, te përgjegjësia, si janë shpërnda ato, nuk i gjeta. Raportimi, kujt i bëhet dhe si i bëhet. Nuk vërejta analizë, sepse mu duk se mungon, pra ku mund të shfaqen rreziqet...

Do të ishte mirë këtij, si përgjigje, të integrohen. E kemi obligim ligjorë hartimin dhe miratimin që ta shtyjme planin përpara. Por, brenda një afati tremujorë, ti integroj aspektet që, unë i konsideroj që mungojnë.

**Sami Kurteshi**, tha se ka ba përpjekje me e pa, me analizue sa duhet se duhet me qenë edh ei informuar. Unë, po e shoh një çështje, atë të auditimit...! Te kjo po dua me u koncentruar: “është auditimit, mungesa e kapaciteteve njerëzore, adresimi jo i duhur i gjetjeve të evidentuara në raportin e auditimit...! Te kjo dua të ndalem: “zbatimi i rekomandimeve, i masave të kontrollit...!” Është shumë e përgjithësuese. Po, auditimi ka të bëjë me integritetin e institucionet. Përgjegjësitë janë të ndara por mendoj që duhet të kihet kujdes ndaj rekomandimit të auditorit të jashtëm, por sidomos ndaj auditorit të brendshëm që i vëren të gjitha, është këtu për cdo ditë...

Kemi rekomadnime të pazbatuara për arsye të ndryshme, por një pjesë më e detajuar duhet ti kushtohet më shumë të dy auditimeve: të jashtëm, është ma e domosdoshme por, edhe auditorit të brendshëm, sepse kuptohet që më shumë t'i kushtohet rëndësi...

**Kreshnik Radoniqi:** Me këto vërejtje, mendoj që ne në parim e votojmë por që të plotësohet mandej. Kush është për miratimin e planit të Integritetit të KQZ-së ?

Me 11 vota për, u miratua ky plan.

#### **4. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

##### **2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës dhe projektit për punëtori me ZEKKZ:

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka shqyrtuar agjendën dhe projektin për punëtorinë me ZEKKZ-të, dhe në këtë takim duke parë edhe shqetësimet e tyre me rregulloren, me sfidat që ata ballafaqohen, me ndryshimet e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme etj., kemi konsideruar që duhet mbajtur një punëtori. Kemi planifikuar që takimi të mbahet më 28 shkurt, dhe punëtorja do të mbahet edhe me përkrahjen e OSBE-së, dhe kuptohet, me përkrahjen e KQZ. Ai pastraj, z. Elshani, pasqyrooi disa prej temave që pritet të shqyrtohen në këtë punëtori...

Rekomandojmë si këshill që të miratohet...

**Sami Kurteshi**, pyeti se a llogaritet që të trajohen të gjitha rregulloret, apo çështjet që prekin këta zyrtarë, sidomos rregullat zgjedhore...? Apo, prezantimi është ëvetëm si orientim.

**Arianit Elshani:** Ata, do të informohen për secilën rregull që përfshinë zyrtarët komunal, ashtu siq do të njoftohen edhe për përgjegjësitë e tyre.. Janë pak rregullore që prekin ata, por kryesisht do jen prezantime të përbashkëta, ata sigurisht kanë edhe mendimet, gjykimet e tyre...

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota miratuan këtë rekomandim.

##### **2.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtori me zyrtarët ekzekutiv të zgjedhjeve për planin e punës dhe planifikim:

**Gordana Llaban**, tha se sot këshilli është takuar dhe ka shqyrtuar buxhetin për punëtori me zyrtarët ekzekutiv të zgjedhjeve për planin e punës dhe planifikim. Është planifikuar që kjo punëtori të mbahet më 28 shkurt. Shpenzimet e ushqimit, vendosjen i mbulon OSBE, dhe pa shpenzime të vogla i mbulon KQZ. Në punëtori marrin pjesë 50 persona, me nga 8 euro, që janë 400 euro planifikim...

Me vota unanime, u miratua buxheti për këtë punëtori.

### **2.3. Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Skenderaj dhe në Dragash:

**Sami Hamiti**, tha se këshilli ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal të komunës së Skenderajt dhe asaj të Dragashit. Të dy rastet kanë përmbushë të gjitha kushtet për zëvendësim. Pas shqyrtimit, rekomandojmë për zëvendësim.

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Skenderajt, Ervina Vojvoda nga subjekti politik Lista e pavarur “Bekim Jashari” e zëvendëson anëtarin e deritashme Fatbardha Halili – Mustafa. Kush është për...?

Me vota unanime, anëtarët e KQZ-së miratuan këtë zëvendësim.

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Dragashit, Naser Myrtezani zëvendësohet nga Gazmend Ramadani nga subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës.

**Arianit Elshani**: meqë, më komunikuan për një pikë që nuk është përfshi në agjendë të temës, pra fjala është për projektin e Edukimit të Votuesve të Rijnë...! Sido qoftë, ky projekt është i miratuar. Kjo, vetëm të vazhdohet procedura, në plan të punës është. Si këshill, kemi dhënë rekomandimin. Pra, sekretariati të vazhdojë me procedurat...

**Të ndryshme!**

